

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**  
**DHOMA PENALE**

*Rr Jordan Misja, Tiranë, adresë web: [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)*

Nr. 925/1 Akti

Dt. 10.06.2020

Dt. Vendimi 22.09.2020

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbërë prej ;

**GJYQTARE - MIGENA LASKA**

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Fahrie GJOÇAJ**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale që i përket:

**KËRKUES:**

*“F... of C... and L... r...”, përfaqësuar nga Av. Ardian VISHA me nr. license 3525, NIPT K81803028A, tel 0692090423, adresë elektronike e-mail avisha@lawyer.com, Dhoma e Avokatisë Tiranë, bazuar në prokurën e përgjithshme nr. 2207 rep, nr. 673 kol, dt. 04.06.2020.*

**PERSON I INTERESUAR:**

**Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e përfaqësuar në gjykim nga prokurore **Anisa Qilimi**.

**OBJEKTI :**

Heqje e Sekuestros së urdhëruar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë në procedimin nr. 9701/2020, ndj llogarive të Shoqatës *“F.. of C.. and L.. r...”*.

**BAZA LIGJORE :**

Neni **212 - 217** i K. Pr. Penale.

Gjykata pasi bëri verifikimin e paraqitjes së palëve, dëgjoi ato të cilat në përfundim kërkuan:

**Kërkuesi & Avokati i tij:** *“Pranimin e kërkesës.”*

**Prokurori:** *“Pranimin e kërkesës”.*

Pasi u shqyrtuan pretendimet e mësipërme të palëve;

**V Ë R E N :**

Nga ky shqyrtimi gjyqësor, bazuar në faktet dhe provat e marra e të administruara në seancë gjyqësore, pjesë e fashikullit gjyqësor, ka rezultuar si më poshtë:

Lidhur me procedimin penal nr. 970/2020, datë 23.01.2020, të regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 11.03.2020 “Për sekuestrimin pranë Bankave”, Prokurori pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka urdhëruar:

“Sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe cdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë në emër e për llogari të shoqërisë tregtare “P.. I..”, me nipt .., me administrator shtetasin H..R..J.., si dhe për shoqëritë tregtare “A.. C..” shpk, me nipt .., me administrator shtetasin M.. E.., për organizatat jofitimprurës “F..” dhe “F.. of C.. A.. and L.. R..”, “B.. I..” shpk, me nr. nipti .., si dhe OJF-QENDËR “C.. of p.. l.. A..” me nr. nipti .., si dhe për shtetasin H.. R..J.., M.. E.., pranë Bankës “BKT”.”

Nga të dhënat operative rezulton se dy subjekte OJF, përkatësisht "F.." dhe "F.. of C.. A.. and L.. R..", pas analizimit të informacionit dhe administrimit të dokumentacionit nga institucione të tjera ligjzbatuese, janë propozuar për kontroll të thelluar operacional ku si gjetje kryesore, ka qenë se subjektet të kenë kryer veprime të shumta financiare, të cilat nuk janë pasqyruar as në deklarata dhe as në bilance.

Sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit bankar rezulton se një prej këtyre subjekteve është kredituar nga subjektet:

"P.. I.." sh.p.k, për të cilin rezulton se: "P.. I.." sh.p.k, është i regjistruar me NIPT ..me aksioner shtetasin e huaj H.. R.. J.. me 75% të aksioneve dhe shtetasin e huaj J.. P..K.. me 25% të aksioneve. Ky subjekt rezulton të ketë të punësuar vetëm një punonjës në listëpagesë që është njëkohësisht edhe administratori i shoqërisë. Nga verifikimet në sistemin tonë tatimor C@TS, ky subjekt nuk ka deklaruar asnjë shitje apo blerje, si dhe nuk ka asnjë bilac të deklaruar.

Sipas përlllogaritjeve ky subjekt rezulton të ketë kredituar: OJF "F.." afërsisht: 3.200.000 Euro; 50.000 USD; 87.000.000 Lekë.

Nga analizimi i bërë deklarimeve të bëra në deklaramet e bera nga subjekti në sitemin informatik tatimor C@TS nuk rezulton që subjekti të ketë kryer asnjë aktivitet tregëtar, nuk ka punonjës të deklaruar në organin tatimor, nuk ka të deklaruar asnjë makineri apo mjete transporti. Nga verifikimi i bërë librave të blerjes dhe të shitjes së subjektit nuk rezulton asnjë shitje apo blerje në subjekte tregëtare.

"A.. C.." sh.p.k, është i regjistruar me NIPT .. me aksioner shtetasin e huaj Hamid R.. J.t me 50% të aksioneve dhe shtetasin e huaj M.. E.. me 50% të aksioneve. Ky subjekt rezulton të ketë të punësuar vetëm një punonjës në listëpagesë që është njëkohësisht edhe administratori i shoqërisë. Nga verifikimet në sistemin tonë tatimor C@TS, ky subjekt nuk ka deklaruar asnjë shitje apo blerje, si dhe nuk ka asnjë bilac të deklaruar. Edhe ndaj këtij subjekti, i cili përfaqësohet dhe administrohet nga shtetasi huaj H.. R..J.., i cili rezulton se

administron dhe përfaqëson jo vetëm subjektin e lartpërmendur, ka rezultuar se, ky subjekt ka kredituar: O.JF "F..." duke kaluar shuma parash ndaj Organizatës Jo Fitimprurëse "F..".

Nga analizimi i materialeve të mësipërme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ka rezultuar, si më poshtë:

Ka dyshime të arsyeshme se nuk i deklarojnë të ardhurat dhe keto të ardhura vinë nga aktivitete të jashtë ligjshme pasi subjektet tregëtare nisur nga deklaratimet që këta subjekte kanë kryer në oraganin tatimor nuk rezultojnë që të kenë kryer aktivitete tregëtar.

Që nga data e krijimit ka patur të regjistruar në listëpages vetëm një përfaqësues ligjor dhe nuk ka pasur të deklaruar në organin tatimor asnjë punonjës pavarësisht se ka qarkullim të lartë parash për të citat nuk justifikohet burimi i ketyre të ardhurave.

Rezultonë që subjektet të kenë kryer veprime të shumta financiare por nuk specifikohet se nga vinë të ardhurat dhe nuk janë plotësuar Pasqyrat Financiare siaps ligjit dhe nuk janë pasqyruar ne Fdp përkatësë dhe as në bilancet e deklaruara nga kompanitë në sistemit tatimorë.

Nga analizimi i bërë deklaratimeve të bëra në deklaratimet e bera nga subjekti në sitemin informatik tatimor C@TS nuk rezulton që subjekti të ketë kryer asnjë aktivitet tregëtarë nuk ka punonjës të deklaruar në organin tatimor, nuk ka të deklaruar asnjë makineri apo mjete transporti. Nga verifikimi i bërë librave të blerjes dhe të shitjes së subjektit nuk rezulton asnjë shitje apo blerje në subjekte tregëtare.

Shuma e kaluar nga Ilogaria bankare e subjekteve në favor të, e kalon shumë prej 4.000.000 Euro, për të cilat nuk dihet burimi i të ardhurave. Kompanitë kanë të njëjtat adresa dhe kontabiliteti i mbahet nga të njëjtat firma.

Për sa më sipër nga analizimi dhe studimi i materialit dhe nga verifikimet e kryera nga ana jonë, bazuar në prova dhe fakte konkludojmë se ka dyshime dhe prova të arsyeshme se subjektet "P.. I.." me nipt L..., me aktivitet "Ndertimi i ndertesave" me adresë "...", pallati i ..", me administrator shtetasin H.. R.. J.. dhe subjektin "A.. C.. " me nipt .. me administrator shtetasin M.. E.. me adresë adresë "...", pallati i .." me aktivitet "shitje të tjera me pakicë.

Nga rrethanat e mësipërme rezulton se fakti parashikohet nga Kodi Penal si vepra penale, nën cilësimin për veprat penale "Fshehja e të ardhurave" parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal, si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale," të parashikuara nga neni 287 dhe 180 të Kodit Penal.

Në lidhje me kete procedim penal është vendosur që të sekuestrohen në cilësinë e proves materiale pranë bankës "BKT", të praktikës së mbajtur për çeljen e llogarisë bankare për shoqërinë tregtare "P.. I..", me nipt .., me administrator shtetasin H..R.. J., si dhe për shoqërinë tregtare "A.. C.." shpk, me nipt .. me administrator shtetasin M. E., për organizatat jofitimprurëse "F..." dhe "F.. of C.. A.. L.. R.", si dhe për shtetasit H..R.. J., M.. E., si dhe të dokumentave justifikues të paraqitur lidhur me transaksionet e kryera.

Avokati i palës kërkuese, gjatë këtij gjykimi, ka pretenduar si më poshtë: Akti i sekuestros rezulton me pasoja te menjehershme penguese ne mbarevajtjen e nje komuniteti masiv shtetasish te huaj (iranian), të mikpritur ne vendin tone me aprovim qeveritar e me një marrëveshje shumëpalëshe ku përfshihen Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR). Pamundësia e veprimit me llogaritë bankare i ka krijuar këtij komuniteti që përbëhet nga Organizata Muhaxhedine e Popullit Iranian (PMOI/MEK), vështirësi të mëdha deri ekzistenciale në territorin e vendit tonë. Kjo Organizatë dhe anëtarët e saj janë të persekutuar politikisht nga regjimi në vendin e origjinës për shkak të bindjeve politike dhe përpjekjeve të tyre për demokraci ne ate vend. Rreth 2700 vetë anetare te saj, janë rezidentë në kampin e Manzës, Durrës të identifikuar me emrin “ASHRAF 3”. Vetë shoqata “F.”, është krijuar për të lehtësuar nga pikëpamja administrative dhe financiare nevojat e përditshme të komunitetit refugjat iranian të pranuar nga qeveria shqiptare. Statusi i kësaj shoqate dhe anëtarëve të saj konsiston në një privilegjim absolut, me burim raportet strategjike të partnerëve tanë kryesorë në politikën e jashtme dhe sigurinë kombëtare nga njera ane, me vendin e origjinës së komunitetit që përbën F..., nga ana tjetër. Financimi përkatës i bërë në favor të nje komuniteti masiv shtetasish te huaj (iranian), të mikpritur ne vendin tone me aprovim qeveritar e me një marrëveshje shumëpalëshe ku përfshihen Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR), i cili është absolutisht autonom e i mbështetur në kontribute dashamirësish dhe anëtarësh të kësaj lëvizjeje politike e sociale iraniane, njihet si Organizata Muxhahedine e Popullit Iranian. I gjithë ky komunitet gëzon një mbrojtje të vecantë bazuar në Konventën e katërt të Gjenevës dhe cdo lëvizje masive e cështje sigurie perkatese, është realizuar nën kujdesin e ushtrisë amerikane.

Në marreveshjen finale, me ndermjetesimin e UNHCR-se, të gjitha kostot mbi banimin, ushqimin dhe kujdesin shëndetësor, i jane lënë këtij komuniteti në mënyrë autonome dhe bazohen kryesisht në kontributet e diasporës iraniane nëpër botë.

Sipas kërkesës së qeverisë shqiptare, prezenca në Shqipëri e një numri të madh iranianësh që bëjnë pjesë edhe në Shoqatën F... që përfaqësoj, nuk ka përbërë deri me tani, barrë për buxhetin e shtetit. Pra, ky komunitet shtetasish te huaj (iranian), të mikpritur ne vendin tone, nuk financohet nga buxheti i shtetit shqiptar. Por, mbi bazë donacionesh vullnetare, kudo nëpër botë.

Dokumenti që sanksionon raportin e mësipërm me shtetin shqiptar është nënshkruar më datë 09.08.2014, e titullohet “Përkushtimi ndaj Shqipërisë i rezidentëve të kampit Liria të Organizatës PMOI”.

Origjina e parasë është transparente dhe duke respektuar kushtet e sigurisë së donatorëve, këta të fundit mbeten të gatshëm të dëshmojnë pa asnjë hezitim, çdo aludim të mundshëm pastrimi parash apo fshehje të ardhurash lidhur me gjithë sa më sipër.

Ndërtimi i kampit në fshatin Manzë, të Durrësit, është realizuar me një transparencë të plotë dhe informim të vazhdueshëm ndaj qeverisë për cdo kontraktues ku përfshihet

kompania "P.". Vetë kampi "ASHRAF 3" është bërë objekt i vizitimit të shumë personaliteteve të tjerë të huaj e vendas.

Për të gjitha këto fakte kërkohet:

"Heqja e sekuestros së urdhëruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 11.03.2020, për llogari të proçedimit penal nr. 970/ 2020, ndaj llogarive bankare të Shoqatës "F..of C.. and L.. r..".

Ky vendim i organit të akuzës Tiranë, Mars 2020, është argumentuar dhe justifikuar me shkakun se, bazuar në kallzimin e regjistruar në lidhje me këtë proçedim penal, shuma e parave të bllokuara, është e pa-justifikuar, dhe ka dyshime se fakti parashikohet nën cilësimin për veprat penale "Fshehja e të ardhurave" parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal, si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale," të parashikuara nga neni 287 dhe 180 të Kodit Penal.

Deri tani nuk rezulton të ketë asnjë akuze konkrete apo ndonjë dyshim të arsyeshëm, të bazuar në prova për ndonjë veprimtari kriminale. Depozitat bankare të këtyre shoqërive, janë sekuestruar nga ana e prokurorisë thjesht si një garanci për ndonjë ecuri eventuale të mëtejshme që do të mund të implikojë subjektet, në vazhdimësi të këtij proçedimi penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, ka njoftuar palën kërkuese, se shuma e parave ishte sekuestruar mbi bazën e kallzimit të ardhur për të cilin është regjistruar dhe proçedimi penal Nr. 970, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, por aktualisht pa ndonjë autor të dyshuar.

• **LIGJI I APLIKUESHËM:**

**SEKUESTRIMET**

**Neni 208**

**Objekti i sekuestrimit**

1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.
2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.
3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm.

**Neni 210**

**Sekuestrimi pranë bankave**

**(Shtesë në pikën 1 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)**

1. Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

**Neni 212**

**Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit**

1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre, mund të bëjnë ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit.

2. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

**Neni 217**

**Kthimi i sendeve të sekuestruara**

1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer.
2. Gjykata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkesën e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruar padinë civile.
3. Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur vendoset konfiskimi.

**Neni 218**

**Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara**

1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.
2. Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.
3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.

**Neni 218**

**“Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara**

1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre. ...”

**Neni 210**

**Sekuestrimi pranë bankave**

**(Shtesë në pikën 1 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)**

1. Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

Pra bazuar në dispozitat e sipër-cituara, sekuestro mund të vendoset vetëm në rastet kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale.

Duke vlerësuar me objektivitet kërkimet e mbrojtjes, duke marrë mbi të gjitha në konsideratë të vecantë faktin se, nëpërmjet llogarive bankare të shoqërive “F..” dhe “F.. of C.. A.. and L.. R..”, kryhet përballimi i të gjitha shpenzimeve jetike, të përditshme, në funksion të jetës, ushqimit, mirëqënies dhe mbarëvajtjes së përditshme të qytetarëve Iranianë, të cilët janë strehuar në territorin shqiptar, nga qeveria shqiptare, por sa kaq nuk financohen prej saj, kjo Gjykatë çmon me vend dhe të arsyeshme që, këto të ardhura financiare të cilat shërbejnë vetëm për këtë qëllim, e mbi këtë funksion, duhet të hiqen nga sekuestro, duke urdhëruar:

Heqjen e sekuestros për llogarite në perkatesi të: “F..” dhe “F.. of C.. A.. and L..R..”.

Aktualisht prokuroria është duke kryer hetimet paraprake të nevojshme, ku konsiston dhe ky procedim penal në vijim.

Pra, organi i akuzës Tiranë, ka dyshime se shuma e parave të transferuara shoqërive, duke qënë se nuk kanë të sqaruar një shkak, qëllim, shpjegim, objekt të sqaruar dhe të motivuar, mund edhe të rrjedhë nga një aktivitet kriminal, për të cilin, vetë pala kërkuese, mund të ketë ose edhe jo dijeni. Rrethana këto të cilat do të sqarohen nga ky proces hetimor, i vijuar si i tillë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përfundimisht kjo Gjykatë çmon se, kërkesa objekt gjykimi, bazuar në tagrat ligjore mbi të cilat Avokati Ardian Visha përfaqëson në këtë gjykim, palën kërkuese “*F.. of C..A.. and L.. R..*” është e drejtë dhe si e tillë duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Gjykata bazuar në nenin 208 – 210 – 212 – 217 - 218 të K.Pr.Penale,

### **VENDOSI:**

- Pranimin e Kërkesës me *nr. 925/1 akti*.
- Heqjen e sekuestros së urdhëruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 11.03.2020, për llogari të procedimit penal nr. 970/ 2020, ndaj llogarive bankare të Shoqatës “F.. of C.. and L..r..”.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi, në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 diteve, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
- **U shpall sot në Tiranë, më dt. 22.09.2020.**

**SEKRETARE  
FAHRIE GJOÇAJ**

**GJYQTARE  
MIGENA LASKA**

**Shpenzime gjyqësore – Nuk ka!**